6					
7					
8					
9					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

- Sipas preventivit të përcaktuar ne Specifikimet Teknike.

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkëlqje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

“Rinovim i sistemit të mbrojtjes për 2 (dy) agregatë me vendosje / konfigurim të releve të reja që zëvendësojnë ato egzistuese REG, RET në HEC Fierzë”.

Përshkrimi i situatës aktuale në HEC Fierzë.

Hyrje

Paneli i mbrojtjes së bllokut Gjenerator-Transformator në HEC Fierze është i realizuar me një grup Relesh dixhitale/numerike të montuara në një panel për çdo bllok-agregat. Këto panele janë të instaluara tek salla e makinave nga ABB gjatë implementimit të projektit të rehabilitimit të HEC Fierze në vitet 2003-2006. Secili panel mbrojtjeje egzistues ka në përbërjen e tij 1 RELE REG*316 V SR200, 1 RELE REG*316 V SR700 për mbrojtjen e gjeneratorit si dhe 1 RELE RET*316 ST330 për mbrojtjen e Transformatorit të fuqisë.

RELE-të egzistuese tek blloku i Agregatit Nr. 1 dhe Agregatit Nr. 3 në HEC Fierze janë të vjetra, të versionit të vjetër 5.1, me sistem operativ DOS, pa suport teknik, nuk ofrojnë siguri operimi.

Shqetesimi kryesor gjatë ditëve të fundit (13,14,15 Janar 2021), nga reletë RET*316 të mbrojtjes diferenciale të bllokut G-T të 4 agregateve në HEC Fierzë, është se ato kanë shfaqur anomali me veprim të gabuar jashtë zonës së mbrojtjes G-T, duke sjellë ndalime të herëpas'herëshme në avari të agregatëve të HEC Fierzë, për rastet e lidhjeve të shkurtra njëfazore me tokën në linjat dalëse 220kV të OST. Këto veprime të gabuara kanë sjellë shqetësime të mëdha për menaxhimin e skedulit të prodhimit si dhe problematika në normalizimin e situatës së gatishmërisë së agregatëve në HEC Fierzë. Anomali të ngjashme reletë RET*316 kanë filluar të shfaqin që në vitin 2018, për rastin e lidhjes në paralel të Sistemit Shqiptar me sistemin e Kosovës, në çastin e kycjes së linjës L12-220kV Fierzë-Prizren.

Nisur sa më sipër, KESH sh.a. kërkon të kryejë rinovimin e sistemit të mbrojtjes për 2 (dy) agregatë me furnizim-vendosje/ konfigurim të seteve të mbrojtjeve të reja që zëvendësojnë relete ekzistuese REG, RET për dy agregatët Nr.1 dhe Nr.3 në HEC Fierzë, zgjidhjen e anomalisë së veprimit të gabuar jashtë zone të mbrojtjes diferenciale të bllokut G-T në këta dy agregatë, si dhe rekomandimin e masave teknike për zgjidhjen e kësaj anomalie edhe në dy agregatët e tjerë jashtë objektit të rinovimit. RELE-të e vjetra që do të demontohen nga këta dy agregatë duhet të dorëzohen në magazinën e HEC Fierzë dhe do të shërbejnë si pjesë rezervë në rast difektsh për Agregatët e tjerë.

Gjithashtu duhet të kryhet furnizimi i një Lap-topi të ri, me kabllot përkatës për komunikimin me RELE-të e reja (USB, kabëll optik, ose në varësi të komunikimit RELE-Laptop), të instalohet software i pajisjes egzistuese OMICRON 256 (pajisje për testimin e RELE-ve të mbrojtjes), duhet të ketë të instaluar software të konfigurimit të RELE-ve përkatëse që do të furnizohen. Theksojmë se Kontraktori duhet të furnizojë së bashku me RELE-të e reja dhe Laptopin e ri me softwaret e pajisjes ekzistuese OMICRON 256 të updatuara, si dhe dy sete kablllo përkatës për komunikimin e Laptopit me RELE-të e reja.

Qëllimi dhe detyrat e investimit

Me këtë investim, kërkojmë të kryejmë rinovimin e sistemit të mbrojtjes për 2 (dy) agregatë me vendosje/konfigurim të seteve të mbrojtjeve të reja që zëvendësojnë relete ekzistuese REG, RET të mbrojtjes së Gjeneratorit dhe Transformatorit të fuqisë për 2 (dy) Agregatët Nr.1 dhe Nr.3 në HEC Fierzë, zgjidhjen e anomalisë së veprimit të gabuar jashtë zone të mbrojtjes diferenciale të bllokut G-T në këta dy agregatë, si dhe rekomandimin e masave teknike për zgjidhjen e kësaj anomalie edhe në dy agregatët e tjerë

jashtë objektit të rinovimit, duke siguruar kushtet normale të punës për këta dy agregatë. Sistemi i ri i mbrojtjeve për 2 (dy) agregatët Nr.1 dhe Nr.3 duhet të konfigurohet dhe testohet me pajisjen OMICRON 256 ekzistuese, pajisje që HEC Fierzë disponon. Konfigurimi dhe testimi i RELE-ve të reja që do të furnizohen, duhet të kryhen me Lap Top-in e ri që do të furnizohet dhe injektimi në sekondar me pajisjen OMICRON 256 që HEC Fierzë disponon, në mënyrë që të kemi të ruajtura dhe të gatshme për të ringarkuar (upload) konfigurimet përkatëse në të ardhmen në rast se do të kemi difekte të RELE-ve të mbrojtjes.

File-et e konfigurimit dhe parametrizimit për secilën RELE REG*316 dhe RET*316 ekzistuese duhet të rikonfigurohen dhe parametrizohen nga fillimi sipas komisionimit fillestar të paneleve të mbrojtjes në versionin e ri për të 2 (dy) Agregatët 1&3 të HEC Fierze dhe të ruhen në folder të përcaktuar për secilin Agregat tek Lap Topi i ri që do të furnizohet së bashku me RELE-të e mbrojtjes.

Në folder të veçantë, tek Lap Topi i ri i mbrojtjes, duhet të ruhen dhe file-t e vjetër (në DOS) të konfigurimit dhe parametrave për secilën RELE mbrojtje REG*316 dhe RET*316 ekzistuese për secilin nga 4 (kater) Agregatët e HEC Fierzë.

Gjatë konfigurimit, parametrizimit të RELE-ve të reja të mbrojtjes (sipas parametrave të komisionimit fillestar) që do të furnizohen për Agregatët Nr.1 dhe Nr.3 dhe testeve për funksionet e mbrojtjes me Lap Topin e ri që do të furnizohet dhe pajisjen OMICRON 256 që HEC Fierzë disponon, duhet të kryhet dhe një trajnim **3 (tre) ditor** me pajisjen OMICRON 256 në objekt për specialistët e HEC Fierzë, ku do të marrin pjesë edhe specialistë nga Drejtoria e Mirëmbajtjes/DGJ, KESH Qendër Tiranë.

Trajnimi për testimet e funksioneve të mbrojtjes me pajisjen OMICRON 256 do të kryhet për konfigurimin e funksioneve të mbrojtjes për setin e RELE-vë të mbrojtjes së gjeneratorit dhe për setin e RELE-vë të mbrojtjes së Transformatorit. Duhet të trajnohen për të kryer parametrizimin e secilës RELE (nga 1 për secilin tip) sipas parametrave të komisionimit të funksioneve të mbrojtjes për Ag. 1 dhe Ag. 3. Duhet të kryhet trajnimi për importimin e file-ve të konfigurimit nga RELE-të e vjetra të mbrojtjes dhe konfigurimi i releve të reja nga fillimi sipas versionit të ri, që të jenë kompatibël me RELE-të e versionit të ri që do të furnizohen, për ruajtjen e backup të fileve egzistues të konfigurimit dhe file-ve të konfigurimit në versionin e ri në Lap Topin e ri të Sistemit të mbrojtjes.

I. Funksionet dhe të dhënat teknike të sistemit të RELE-ve ekzistuese dixhitale/numerike të mbrojtjeve.

I.1 Releja dixhitale/numerike për mbrojtjen e Transformatorit të fuqisë RET_316*4 ST 330 (Numerical Transformer Protection) ose ekuivalent kryen funksionet e mbrojtjes: F87T, F50, F51.

Të dhënat teknike: $I_n=5A$, $f_n=50Hz$, $U_{aux}=48 VDC$. Përmasat në panelin e mbrojtjes 271mmX276mm (montimi në panelin e mbrojtjes).

Releja dixhitale për mbrojtjen e Transformatorit kryen funksionet e mbrojtjes sipas tabelës.

Funksioni i mbrojtjes	Përshkrimi <i>Description</i>
87T	Mbrojtje diferenciale e bllokut Gjenerator-Transformator <i>Transformer differential protection</i>
50	Mbrojtja e rrymës së çastit <i>Instantaneous overcurrent</i>
51	Mbrojtja e rrymës maksimale <i>Overcurrent protection</i>
	Rezervë

	<i>Spare</i>
	Rezerve <i>Spare</i>
	Rezerve <i>Spare</i>
	Mbrojtja gazore dhe nga veprimi i valvoles se sigurise se transformatorit. (stakim) <i>Buchholz relay & Safety valve (trip)</i>
	Mbrojtja nga rritja e temperatures se vajit dhe peshtjellave ne transformator (sh1 alarm, sh2 stakim). <i>Oil temperature & Winding temperature protection (1st step-alarm 2st step-trip)</i>

I.2 Releja dixhitale/numerike për mbrojtjen e Gjeneratorit REG_316*4 SR 200 (Numerical Generator Protection) ose ekuivalent kryen funksionet e mbrojtjes: F87G, F78, F49, F59, F21, F27, F81<, F81>, F51-V.

Te dhenat teknike: In=5A, Un=100V, fn = 50Hz, Uaux=48V DC. Përmasat në panelin e mbrojtjes 271mmX276mm (montimi në panelin e mbrojtjes).

Releja dixhitale për mbrojtjen e Gjeneratorit kryen funksionet e mbrojtjes sipas tabelës.

Funksioni i relese	Pershkrimi <i>Description</i>
87G	Mbrojtja diferenciale e gjeneratorit <i>Generator differential protection</i>
78	Mbrojtja nga shkatrja e polit (sh1 alarm, sh 2 stakim) <i>Pole sleeping (1st step-alarm, 2st step-trip)</i>
49	Mbrojtja nga mbingarkesa ne stator (<i>sh1 alarm, Sh2 stakim</i>) <i>Stator overload protection (1st step-alarm, 2st step-trip)</i>
59	Mbrojtja nga tensioni maksimal (<i>sh1 alarm, Sh2 stakim</i>) <i>Overvoltage protection (1st step-alarm, 2st step-trip)</i>
21	Mbrojtja nga impendanca e ulet (<i>sh1 alarm, Sh2 stakim</i>) <i>Underimpedance protection (1st step-alarm, 2st step-trip)</i>
27	Mbrojtja nga tensioni minimal <i>Undervoltage protection</i>
81G	Mbrojtja nga rritja / ulja e frekuences (stakim me shkalle) <i>Over / under frequency (step-trip)</i>
51V(51/27)	Mbrojtja e rrymes maksimale me kontroll nga tensioni minimal <i>Voltage controlled overcurrent</i>

I.3 Releja dixhitale/numerike për mbrojtjen e Gjeneratorit REG_316*4 SR 700 (Numerical Generator Protection) ose ekuivalent duhet të realizojë funksionet e mbrojtjes: F64R, F32, F64S, F50, F21, F40, F46, F59/81>, F51-INV, Logic to ext CB open.

Theksojmë se funksionet e mbrojtjes 64R dhe 64S (Mbrojtja tokë në Rotor dhe Mbrojtja tokë në Stator), Rele-ja egzistuese e mbrojtjes së gjeneratorit e kryen nëpërmjet relesë ekzistuese të injektimit REX 010 dhe bllokut te transformimit REX011 instaluar tek nuli i gjeneratorit. Te dhenat teknike: In=5A, Un=100V, fn = 50Hz, Uaux=48V DC. Përmasat në panelin e mbrojtjes 271mmX276mm (montimi në panelin e mbrojtjes).

Releja dixhitale për mbrojtjen e Gjeneratorit kryen funksionet e mbrojtjes sipas tabelës.

Funksioni i relese	Pershkrimi <i>Description</i>
64R	Mbrojtja toke ne rotor (sh1 alarm, sh2 stakim) <i>Rotor earth fault protection. (1st step-alarm, 2st step-trip)</i>
32	Mbrojtja nga fuqia ne drejtim te kundert <i>Reverse power protection</i>
64S 90%	Mbrojta toke ne stator 90% (alarm) <i>Stator earth fault protection 90% (alarm)</i>
64S 100%	Mbrojta toke ne stator 100% (stakim) <i>Stator earth fault protection 100% (trip)</i>
50	Mbrojtje e rrymes se çastit <i>Instantaneous overcurrent protection</i>
51INV	Mbrojtja e rrymes maksimale me karakteristike inverse <i>Overcurrent protection</i>
46	Mbrojtje nga rryma e renditjes se kundert. (sh1 alarm, sh2 stakim) <i>Negative sequence current (1st step-alarm, 2st step-trip)</i>
40	Mbrojtje nga humbja e eksitimit <i>Loss of excitation (under-reactance)</i>
59/81	Mbrojtja nga mbieksitimi U/f (sh1 alarm, sh2 stakim) <i>Overexcitation (overflux U/F protection) (1st step-alarm, 2st step-trip)</i>
21	Mbrojtja nga impedanca e ulet e Gen (sh1 alarm, sh2 stakim) <i>Generator under-impedance protection (1st step-alarm, 2st step-trip)</i>

II. Termat e Referencës dhe specifikimet teknike bazë, për rinovimin e sistemit të mbrojtjes për 2 (dy) agregatat Nr.1 dhe Nr.3, me furnizim-vendosje / konfigurim të seteve të mbrojtjeve të reja që zëvendësojnë ato ekzistuese REG, RET në HEC Fierzë.

Sistemi i releve të reja për rinovimin e sistemit të mbrojtjeve, duhet të realizojë zgjidhje teknike të avancuar me rele dixhitale/numerike të gjeneratës më të re të provuar në industri, për mbrojtjen e gjeneratorit dhe transformatorit, me performancë të lartë në frekuenca të ndryshme me vlera (50 Hz, 60 Hz dhe 16.7 Hz).

Sistemi i releve të reja duhet të jetë i përshtatshëm për tu montuar në Rack (kabinet) në të njëjtin vend ku do të hiqen relete ekzistuese (strehim 1/2 ose 19”).

Reletë kërkohet të kenë të paktën 32 hyrje dhe dalje dixhitale me mundësi zgjerimi si dhe duhet të kenë programin e parametrizimit të tyre, me të cilin mund të kryhen provat në matricat e stakimit (trip matrix), etj.

Reletë e reja duhet të jenë të pajisura me panel ndërveprues (ekran me prekje/ose me kursor) për vendosjen e parametrave që lejon tarimin e qartë dhe të lehtë të releve.

Në vijim jepet tabela e parametrave bazë të sistemit të releve të reja.

RELEJA MBROJTJESË	
Tipi	Rele kompakte ose modulare
Shasia	E montueshme në rack
Madhësia e Shasisë	Strehim 1/2 ose 19”
Ekрани	Ndërveprues (me prekje/ose me kursor)
Funksionet e Ekranit	Vizualizim i proceseve të releve
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
	IEC 60870-5-104

Protokollet e Komunikimit	IEC 60870-5-103
	Modbus TCP
KARAKTERISTIKAT TEKNIKE	
Funksionet Mbrojtëse	Gjenerator & Transformator
Frekuenca	51 Hz, 60 Hz dhe 16.7 Hz
Hyrjet nga Transformatorët e rrymës	Sasia 12/24, vlera nominale 1A dhe 5A
Hyrjet nga transformatorët e tensionit	Sasia 8-64, vlera nominale 100-125 VAC
Hyrje Dixhitale dhe kontaktet e sinjaleve	8 – 72
PAJISJET e INJEKTIMIT DHE TRANSFORMIMIT	
Gjenerator i tensionit të sinjalit 20Hz ose ekuivalent për funksionin 64S 100% dhe 64S	
Filtër me brez 20 Hz ose ekuivalent	
Transformator Tensioni tek nuli i gjeneratorit për injektimin e sinjalit 20 Hz ose ekuivalent	
Transformator rryme tek nuli i gjeneratorit për injektimin e sinjalit 20 Hz ose ekuivalent	
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”	1 (nje) vit nga data e marrjes në dorëzim

Spjegojmë se për rritjen e sigurisë së veprimit dhe redundancën e sistemit të mbrojtjes së gjeneratorit, disa nga funksionet e mbrojtjes së gjeneratorit, kërkohet që të jene të dubluara. Për të realizuar funksionin e mbrojtjes 64S 100% (Mbrojtja tokë në Stator 100%), dhe 64R (Mbrojtja tokë në rotor), sistemi i mbrojtjes së gjeneratorit që do të furnizohet duhet të jetë i pajisur me modulën e ri shtesë të veçantë ose të integruar për injektimin e sinjalit 20 Hz, ose ekuivalent, i shoqëruar me filtrin përkatës 20Hz ose ekuivalent.

Seti i injektimit të sinjalit përveç gjeneratorit dhe filtrit të sinjalit, duhet të përfshijë 2 transformatorë tensioni dhe 2 transformatorë rryme, të cilët do të instalohen tek nuli i gjeneratorit të secilit Agregat Nr.1 dhe Nr.3.

II.1 Seti i mbrojtjes së Transformatorit.

Të dhënat teknike ku do të instalohet seti i mbrojtjes:

$f_n=50\text{Hz}$, $U_{aux}=48\text{ VDC}$.

Funksionet e setit të mbrojtjes për Transformatorin e fuqisë që do të furnizohet dhe instalohet tek paneli i mbrojtjes për secilin nga 2 Agregatët Nr. 1 dhe Nr.3, jepen në specifikimet me poshtë, në tabelën përmbledhëse. Gjithashtu kjo RELE duhet të ketë input-output rezervë.

Krahas funksioneve të relese RET egzistuese, seti i mbrojtjes së re të transformatorit, duhet të ketë edhe funksionin shtesë të mëposhtëm:

87REF - Diff. 2-inp.2-ph.-S

Për realizimin e funksionit **87REF**, lidhja e rrymave në setin e relese së transformatorit, duhet të bëhet në mënyrë diferenciale ndërmjet transformatorit të rrymës së neutrit të transformatorit të fuqisë (*në anën e lidhjes yll*), me transformatorin e rrymës së fazës së transformatorit në anën e TL në N/stacionin 242kV, rrymë e cila njëkohësisht shkon në setin e relese edhe për realizimin e funksionit të mbrojtjes diferenciale të bllokut **87T (B)**.

Kërkesat për realizimin e funksionit të mbrojtjes diferenciale të bllokut 87T(B).

Skema e mbrojtjes 87T(B) do të realizojë mbrojtjen diferenciale të bllokut G-T, duke përdorur transformatorët egzistues të rrymës si nga neutri i gjeneratorit po ashtu nga ana e TL të transformatorit të fuqisë dhe nga ana e neutrit të tij (ana e lidhjes në yll të transformatorit).

Spjegojmë se skema e lidhjes së grupit G-T me sistemin 220 kV tek N./stacioni 242kV OST Fierzë, realizohet nëpërmjet një skeme **OSE**:

- Nëpërmjet çelësit të bllokut 1Ç1 (1Ç1 për Ag1 dhe 3Ç1 për AG3), blloku GT lidhet me zbarën 1 220kV të N./stacionit 242kV OST Fierzë, ose,
- Nëpërmjet çelësit 1Ç2 (1Ç2 për Ag1 dhe 3Ç2 për AG3), blloku GT lidhet direkt me linjën përkatëse 220kV, dalëse nga N/stacioni 242 kV OST Fierze.

Prandaj edhe informacionet e rrymave trefazore nga transformatorët e rrymës (CT) të anës 220 kV të blloqeve G-T, hyjnë në paralel tek qarqet e rrymave të setit të mbrojtjes diferenciale të bllokut G-T **87T(B)**.

Përpara instalimit të setit të mbrojtjes së re të transformatorit, kontraktori me specialistët e prodhuesit duhet të testojë transformatorët e rrymës egzistues të mbrojtjes që lidhen me funksionin 87T, për krahasim me kurbat origjinale të testimeve të kryera gjatë komisionimit në HEC Fierzë.

Per funksionin 87T(B), testimi i karakteristikave voltampere(kurbat e saturimit) të transformatorëve egzistues të rrymës do të behet:

-Nga ana 220 kV, per CT-te tek çelësi Ç1 dhe per CT-te tek çelësi Ç2, përkatësisht per Ag1 dhe Ag3, ne total 6 CT per nje agregat ose 12 CT per Ag1 dhe Ag3.

-Nga ana e neutralit të gjeneratorit, per 3 CT-te e secilit agregat, ose 6 CT per Ag1 dhe Ag3.

-Nga zbarat e gjeneratorit tension 13.8 kV (inputi i trete i 87T(B) per ngarkesën e transformatorit të nevojave vetjake & eksitimit), 3 CT-te e secilit agregat, ose 6 CT per Ag1 dhe Ag3.

Seti i mbrojtjes së re të transformatorit, duhet të ketë parametra të konfigurueshëm për rrymat e renditjes zero, për harmonikat e dyta dhe të pesta, për ngopjen e transformatorëve të rrymës, për rrymat inrush, për grupin e lidhjes së transformatorit të fuqisë, në mënyrë që të diskriminojë të gjitha rastet e lidhjeve të shkurtra jashtë zonës së veprimit G-T me ato brenda zonës së veprimit G-T.

Në vijim, lista e parametrave të konfigurueshëm që kërkohen për funksionin 87T(B):

Operate Value: %
 Bias: %
 Vector Group 1-2:
 Zero Sequ.Fil.Sys.1: ON/OFF ose parameter seting
 Zero Sequ.Fil.Sys.2: ON/OFF ose parameter seting
 2nd Harmonic: %
 5th Harmonic: %
 High Set OC: %
 CT Ratio Comp. 2-1:
 Interlockings: Cross Blocking/
 Saturation Detection: Periods

Më poshtë jepet tabela përmbledhëse e funksioneve të setit të mbrojtjes së transformatorit:

Funksioni i mbrojtjes	Përshkrimi <i>Description</i>
87T(B)	Mbrojtje diferenciale e bllokut Gjenerator-Transformator (3-ph.-S) <i>Block Generator Transformer differential protection (3-ph.-S)</i>
87REF	Mbrojtja diferenciale nga lidhjet e shkurtra me tokën në transformator (Diff. 2-inp.2-ph) <i>Generator transformer restricted earth fault protection (Diff. 2-inp.2-ph)</i>
50M	Mbrojtja e rrymës së çastit <i>Instantaneous overcurrent</i>
51 Inv	Mbrojtja e rrymës maksimale <i>Overcurrent protection</i>
	Mbrojtja gazore dhe nga veprimi i valvoles së sigurisë së transformatorit. (stakim) <i>Buchholz relay & Safety valve (trip)</i>
	Mbrojtja nga rritja e temperaturës së vajit dhe peshtjellave në transformator (sh1 alarm, sh2 stakim). <i>Oil temperature & Winding temperature protection (1st step-alarm 2st step-trip)</i>

II.2 Seti i mbrojtjes se Gjeneratorit.

Të dhënat teknike ku do te instalohet seti i mbrojtjes:

$f_n=50\text{Hz}$, $U_{aux}=48\text{ VDC}$.

Për rritjen e sigurisë së veprimit dhe redundancën e sistemit të mbrojtjes së gjeneratorit, disa nga funksionet e mbrojtjes së setit të ri te mbrojtjes së gjeneratorit duhet të jenë të dubluara.

Seti i mbrojtjes së gjeneratorit, kërkohet të realizojë funksionet e dy mbrojtjeve ekzistuese REG_316*4 SR 200 dhe REG_316*4 SR 700, si dhe të bëjë dublimin e disa funksioneve sa më poshtë përshkruhet në tabelat përkatëse, duke tejkaluar performancën e sistemit të releve ekzistuese.

Kerkohej te konfigurohet edhe nje funksion shtese qe mungon ne relete egzistuese, pikërisht funksioni, $I > U < 50/27$, Mbrojtja nga energjizimi aksidental me agregat te ndalur (*Inadvertent energization*).

Edhe ky funksion duhet te konfigurohet i dubluar.

Kjo kerkese vjen si domosdoshmëri teknike, pasi skema e lidhjes se bllokut GT me rrjetin 220kV behet nëpërmjet konfigurimit te ashtuquajtur “nje çelës e gjysme”(breaker-and-a-half bus configuration).

Kerkesat per realizimin e funksionit te mbrojtjes diferenciale te Gjeneratorit 87G.

Skema e mbrojtjes 87G do te realizoje mbrojtjen diferenciale te gjeneratorit, duke përdorur transformatorët egzistues te rrymës si nga neutri i gjeneratorit ashtu nga ana e tensionit 13.8kV te gjeneratorit.

Përpara instalimit të setit të mbrojtjes së re të gjeneratorit, kontraktori me specialistët e prodhuesit duhet të testojë transformatorët egzistues te mbrojtjes qe lidhen me funksionin 87G, për krahasim me kurbat origjinale të testeve të kryera gjate komisionimit në HEC Fierzë.

Per funksionin 87G, testimi i karakteristikave voltampere (kurbat e saturimit) te transformatorëve egzistues te rrymës do te behet:

-Nga ana e neutralit te gjeneratorit, per 3 CT-te e secilit agregat, ose 6 CT per Ag1 dhe Ag3.

-Nga ana e terminaleve 13.8 kV te gjeneratorit, per 3 CT-te e secilit agregat, ose 6 CT per Ag1 dhe Ag3.

Seti i mbrojtjes së re të Gjeneratorit, duhet të ketë parametra të konfigurueshëm në mënyrë që të diskriminojë të gjitha rastet e lidhjeve të shkurtra jashtë zonës së veprimit me ato brenda zonës se veprimit.

Parametrat e konfigurueshëm, kërkohen për të paktën këto parametra:

Operate Value: %

Bias: %

High Set OC: %

Saturation Detection: Periods

Funksionet e mbrojtjeve që duhet të realizojë seti i mbrojtjes së gjeneratorit përshkruhet sipas dy tabelave ne vijim.

*II.2.1 Funksionet e mbrojtjes që duhet të realizojnë reletë e reja që do të zëvendësojnë ato ekzistuese REG_316*4 SR 200 dhe REG_316*4 SR 700, plus funksionet e dubluara.*

Funksioni i mbrojtjes	Pershkrimi <i>Description</i>	REG_316*4 SR 200, plus funksionet e dubluara	REG_316*4 SR 700, plus funksionet e dubluara.
87G	Mbrojtja diferenciale e gjeneratorit(3-ph.-S) <i>Generator differential protection(3-ph.-S)</i>	X	

78	Mbrojtja nga shkarja e polit (sh1 alarm, sh 2 stakim) <i>Pole sleeping (1st step-alarm, 2st step-trip)</i>	X	X(dubluar)
49	Mbrojtja nga mbingarkesa ne stator (sh1 alarm, Sh2 stakim) <i>Stator overload protection (1st step-alarm, 2st step-trip)</i>	X	
51V	Mbrojtje e rrymes maksimale me tension minimal <i>Voltage controlled overcurrent</i>	X	X(dubluar)
32	Mbrojtja nga fuqia ne drejtim te kundert <i>Reverse power protection</i>	X	X(dubluar)
50G	Mbrojtje e rrymes se çastit <i>Instantaneous overcurrent protection</i>	X	
51INV	Mbrojtja e rrymes maksimale me karakteristike inverse <i>Overcurrent protection Inv.</i>	X	
46	Mbrojtje nga rryma e renditjes se kundert. (sh1 alarm, sh2 stakim) <i>Negative sequence current (1st step-alarm 2st step-trip)</i>	X	
40	Mrojtje nga humbja e eksitimit <i>Loss of excitation (under-reactance)</i>	X	X(dubluar)
21	Mbrojtja nga impedanca e ulet e Gen (sh1 alarm, sh2 stakim) <i>Generator under-impedance protection (1st step-alarm 2st, 2st step-trip)</i>	X(dubluar)	X
59/81 U/f	Mbrojtja nga mbieksitimi U/F (sh1 alarm, sh2 stakim) <i>Overexcitation (overflux U/F protection) (1st step-alarm, 2st step-trip)</i>		X
78	Mbrojtja nga shkarja e polit (sh1 alarm, sh 2 stakim) <i>Pole sleeping (1st step-alarm, 2st step-trip)</i>	X(dubluar)	X
59	Mbrojtja nga tensioni maksimal (sh1 alarm, Sh2 stakim) <i>Overvoltage protection (1st step-alarm, 2st step-trip)</i>		X
27	Mbrojtja nga tensioni minimal <i>Undervoltage protection</i>		X
81G	Mbrojtja nga rritja / ulja e frekuences (stakim me shkalle) <i>Over / under frequency (step-trip)</i>		X
51V(51/27)	Mbrojtja e rrymes maksimale me kontroll nga tensioni minimal (<i>Voltage controlled overcurrent</i>)	X(dubluar)	X
I> & U< 50/27	Mbrojtja nga energjizimi aksidental me agregat te ndalur <i>Inadvertent energization</i>	X	X(dubluar)
32	Mbrojtja nga fuqia ne drejtim te kundert <i>Reverse power protection</i>	X(dubluar)	X
64S 90%	Mbrojtja toke ne stator 90% (alarm) <i>Stator earth fault protection 90% (alarm)</i>		X
64S 100%	Mbrojtja toke ne stator 100% (stakim) <i>Stator earth fault protection 100% (trip)</i>		X
64R	Mbrojtja toke ne rotor (sh1 alarm, sh2 stakim) Rotor earth fault protection. (1st step-alarm 2st, 2st step-trip)		X
40	Mrojtje nga humbja e eksitimit <i>Loss of excitation (under-reactance)</i>	X(dubluar)	X

Për sa me sipër kërkohet:

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë propozimin teknik si dhe skemën e lidhjes, të konfirmuar nga prodhuesi, ku të paraqiten funksionet e mbrojtjes dhe dublimi i tyre.

Në të gjitha rastet e dublimit të funksioneve të mbrojtjeve, operatori ekonomik duhet të ketë parasysh që do të kryejë të gjithë modifikimet e nevojshme në secilin panel mbrojtjeje të AG1&AG3, për realizimin me sukses të dublimit të funksioneve të mbrojtjes.

III. Kërkesa për Lap Top të ri

Duhet të bëhet furnizimi me një laptop të ri ku të jetë i instaluar programi për konfigurimin e RELE-ve të reja, për parametrizimin e tyre. Tek Laptopin e ri do të instalohet dhe software i pajisjes Omicron 256 (disponohet në HEC Fierzë), që shërben për konfigurimet dhe testimet në vend gjatë trajnimit.

Gjithashtu Kontraktori do të kryejë dhe furnizimin me dy sete kablllo komunikimi Laptop-RELE.

Specifikimet teknike dhe kërkesat minimale për Laptopin e ri.

LAPTOP	
“Chipset”:	Intel ose Ekuivalent
Pikët Min. për Procesorin	6400 pike
“RAM”:	8 GB, DDR4 min. 2666 MHz, Non-ECC
Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:	500 GB SSD
“Graphics”:	Integrated Graphics with 2 GB, d e d i c a t e d
“Media Device”:	DVD+/-RW with DL Internal ose External; Memory card reader
Ekрани “Display”:	15.6” LED FHD (1920 x 1080), Anti Glare
Bateria “Battery”:	Min. 45 Wh
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (3) porta USB nga të cilat min. (2) USB 3.0 (1) DisplayPort/HDMI (1) Integrated Mic. (1) Integrated HD Web Camera (1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack
Rrjeti “Networking”:	10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11 b/g/n); Bluetooth min. V4.0
“Sound”:	Integrated , (2) x built-in speakers (stereo)
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.S.”:	OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”:	QWERTY
“Pointing Device”:	Touch Pad
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
Ushqyesi “Recharger”:	Po
“Mouse”:	Po, i të njëjtës Markë me Laptopin
Çanta “Carrying Bag”:	Po, nga Prodhuësi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë.
“Recover”:	Recover Partition
GARANC	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

IV. Trajnimi

Duhet të kryhet dhe një trajnim nga personeli i specializuar i prodhuesit te Releve, **3 (tre) ditor** në objekt për specialistët e HEC Fierze ku do të marrin pjesë dhe specialistë nga Drejtoria e Mirëmbajtjes/DGJ, KESH Qendër Tiranë.

Trajnimi për testimet e funksioneve të mbrojtjes me pajisjen OMICRON 256 do të kryhen për konfigurimin e funksioneve të mbrojtjes për 1 (një) RELE të mbrojtjes së gjeneratorit dhe 1 (një) RELE mbrojtje të Transformatorit, nga RELE-të e reja që do të furnizohen. Duhet të trajnohen për të kryer parametrizimin e secilës RELE (nga 1 për secilin tip) sipas parametrave të komisionimit të funksioneve të mbrojtjes për Ag. 1 dhe Ag. 3. Duhet të kryhet trajnimi për importimin e file-ve të konfigurimit nga RELE-të e vjetra të mbrojtjes, për ruajtjen e backup të fileve egzistues të konfigurimit dhe file-ve të reja të konfigurimit në versionin e ri në Lap Topin e ri të Sistemit të mbrojtjes.

-Brenda detyrës se trajnimit duhet të kryhet edhe importimi i fileve të konfigurimit për të gjitha RELE-të ekzistuese RET_316*4 ST 330, REG_316*4 SR 200, REG_316*4 SR 700 tek secili nga 4 Agregatet dhe ruajtja e këtyre file-ve si backup tek Laptopi i ri.

V.Komisionimi e testet me ngarkesë të 2 agregatëve me mbrojtjet e reja.

Përpara instalimit të setit të mbrojtjes së re të transformatorit dhe të gjeneratorit, kontraktori me specialistët e prodhuesit, duhet të realizojë testimet e karakteristikave voltampere (kurbat e saturimit) te transformatorëve egzistues të mbrojtjes, qe lidhen me realizimin e funksioneve 87G dhe 87T, sipas specifikimeve dhe preventivit, për krahasim me kurbat origjinale të testeve të kryera gjatë komisionimit në HEC Fierzë.

Nëpërmjet këtij rinovimi, detyrë e kontraktorit është zgjidhja definitive e anomalisë së veprimit të gabuar jashtë zone të mbrojtjes diferenciale të bllokut G-T në agregatët Nr.1 dhe Nr.3 tek të cilët do të bëhet rinovimi i sistemit të mbrojtjeve, si dhe rekomandimi i masave teknike për zgjidhjen e kësaj anomalie edhe në dy agregatët e tjerë jashtë objektit të rinovimit.

Kontraktorit do ti vihen në dispozicion gjithë manuallet dhe Laptopi i vjetër me file-t e konfigurimit të mbrojtjeve egzistuese.

Pas konfigurimeve dhe testeve me injektim ne sekondar për të gjitha funksionet e mbrojtjeve me pajisjen Omicron 256 për sistemin e RELEVE-të te reja që do të furnizohen, do të kryhet nga kontraktori demontimi i Releve egzistuese dhe instalimi i seteve të Rele-ve të reja në panelet e mbrojtjes tek Agregati Nr. 1 dhe Nr.3. Pas instalimit duhet të kryhen provat për veprimin e të gjithë funksioneve të mbrojtjes për setet e releve te reja. Pasi kjo provë të realizohet me sukses, duhet të kryhet prova 72 Orëshe me ngarkesë për Agregatin Nr. 1 dhe Nr. 3.

Reletë e vjetra do të dorëzohen në magazinën e HEC Fierzë.

Testet e konfigurimeve në vend për Rele-të e reja duhet të relatohen në raportin final te komisionimit te sistemit te mbrojtjeve te rinovuara (Protection commissioning report).

Preventivi.

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Seti i mbrojtjes për Gjeneratorin, sipas specifikimeve.	set	2		
2	Seti i mbrojtjes për Transformatorin e fuqisë, sipas specifikimeve.	set	2		
	Gjenerator i tensionit të sinjalit 20Hz		2		

3	ose ekuivalent për funksionin 64S 100% dhe 64R	set			
	Filtër me brez 20 Hz ose ekuivalent				
	Transformator Tensioni dhe Transformator rryme tek nuli gjeneratorit për injektimin e sinjalit 20 Hz ose ekuivalent				
4	Testimi i karakteristikave volt-ampere (kurbat e saturimit) të transformatorëve egzistues të rrymës nga ana 220 kV për funksionin 87T (B), për Ag1 dhe Ag3 (CT-te tek çelësat Ç1 dhe CT-te tek Ç2).	cope	12		
5	Testimi i karakteristikave volt-ampere (kurbat e saturimit) të transformatorëve egzistues të rrymës të neutrit, të terminaleve 13.8kV dhe zbarave 13.8 kV për funksionin 87G dhe funksionin 87T (B) për Ag1 dhe Ag3.	cope	24		
6	Demontimi i Releve egzistuese, konfigurimi dhe testimi i funksioneve të releve të reja, instalimi dhe rilidhja në skemë të releve të reja, testimi për të dy sistemet e mbrojtjes së Ag.1 dhe Ag.3.	set	2		
7	Lap top me programin për konfigurimin e RELE-ve të reja, sipas specifikimeve	cope	1		
8	Trainimi i plote 3 ditor për konfigurimin e releve të reja, back-upet e fileve dhe testet, sipas specifikimeve.	Komplet	1		

➤ **Garancia për difektet.**

Për setet e mbrojtjeve, 1(nje) vit nga data e marrjes në dorëzim, nga prodhuesi garancia 2(dy) vjet.

Për lap-Top-in e testimit të mbrojtjeve, garancia 3 (tre) vjet.

➤ **Dokumentacioni teknik bashkëlidhur specifikimeve:**

I. Skema njevijore e TL e N/stacionit 242 kV Fierze.

II. Skema elektrike e mbrojtjeve të aggregateve në HEC Fierze, që përmban:

1. Pamje e përgjithshme e panelit egzistues të mbrojtjes.
2. Bllokskema e mbrojtjes Gjenerator –Transformator për Agregatin Nr.1/3.
3. Skema elektrike e lidhjes së rezistencës në nuln e gjeneratorit së bashku me transformatorin e injektimit.

Dokumentacioni shoqerues i mallrave objekt prokurimi.

1. Autorizim prodhuesi,
2. Çertifikata e origjinës nga prodhuesi;
3. Deklarate/Certifikate CE, nga prodhuesi.
4. Manualet e releve të reja të furnizuara.
5. Test reportet e komisionimit në vend.
6. Çertifikata e garancisë nga kontraktori.
7. Çertifikata e garancisë nga prodhuesi (2 vjet).
8. Deklaratë se mallrat janë të rinj e të papërdorur,
9. Packing list,

❖ Shënim:

Ofertuesit e interesuar, brenda periudhës të publikimit të dokumentave të tenderit, janë të ftuar të kryejnë site-visit për tu njohur dhe familjarizuar me sistemin e mbrojtjeve egzistuese.

Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet: “Rinovim i sistemit të mbrojtjes për 2 (dy) agregatë me vendosje / konfigurim të releve të reja që zëvendësojnë ato egzistuese REG, RET në HEC Fierzë”, në përputhje me sasi të preventivit bashkëlidhur DT.

Afatet e lëvrimit:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
	Në përputhje me zërat e përcaktuara në specifikimet teknike, bashkëlidhur DT.		KESH sh.a – Njesia e Prodhimit HC/FIERZE	15 muaj nga hyrja në fuqi e kontrates

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Bazuar sa më sipër.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet 2018, 2019, 2020 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2018, 2019, 2020) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese*. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,*

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, të cilat duhet të perkojnë me kategorinë dhe specifikën e produkteve që prokurohen, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si me poshtë :

- a) ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”
- b) ISO 14001-2015 "Sistemi i menaxhimit të mjedisit"
- c) ISO 18001:2007 / 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”
- d) ISO 50001:2011 “Sistemi i menaxhimit të energjisë”

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 2 dy inxhinierë elektrike/informatike me experience jo me pak se 5 vite në menaxhim të projekteve inxhinierike.

Për të provuar plotësimin e këtij kushti OE duhet të paraqesë në tender dhe të vetedeklarojë në Shtojcën 8 se plotëson dokumentacionin e mëposhtëm:

- Diplomen e inxhinierëve
- Kontratat të vlefshme pune
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formularit E/Sig-25, për periudhën Qershor 2021
- CV-te e inxhinierëve

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimumi punonjësit e mëposhtëm të çertifikuar për:

- 1 (një) inxhinier të çertifikuar me certifikatë ndërkombetare për Menaxhim Projekti
- 1 (një) inxhinier i çertifikuar për sigurinë teknike në punë ndaj elektricitetit (deshmi kualifikimi i sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të)
- 1 (një) punonjës të çertifikuar për testimin dhe komisionimin e releve mbrojtëse
- 1 (një) punonjës të çertifikuar mbi sistemet 3-fazore të fuqisë
- 1 (një) punonjës të çertifikuar mbi testimin dhe mbrojtjen e transformatoreve të fuqisë

Për të provuar plotësimin e këtij kushti OE duhet të paraqesë në tender dhe të vetedeklarojë në Shtojcën 8 se plotëson dokumentacionin e mëposhtëm:

- Certifikatat përkatëse
- Diplomat për inxhinierët
- Kontratë Punë të Vlefshme
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formularit E/Sig-25, për periudhën Qershor 2021

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- ✚ Autorizim prodhuesi ose distributor të autorizuar për mallrat objekt prokurimi. Në autorizimin e prodhuesit duhet të jenë të shënuar të dhënat e sakta si: numri i telefonit të prodhuesit, adresë e-mail, në rast verifikimi nga ana e Autoritetit Kontraktor. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, certifikatë, deklaratë etj).
- ✚ Katalogun/ët teknik për mallrat që do të furnizojë për këtë objekt prokurimi në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike. Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.

✚ Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për projekte të ngjashme për rinovimet e sistemit të mbrojtjeve të gjeneratoreve dhe transformatoreve të lëshuara nga institucione të autorizuar me ligj ose nga prodhuesi të kryera më parë, që të vërtetojnë pajtueshmërinë e sistemit të mbrojtjeve të prodhuara, me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.

2.3.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë se mallrat janë të rinj, të pa përdorur.

